



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. _____ prot

Tirane, me 19.11.2018

UDHEZIM nr. _____

(Për administrimin e procesit të mbledhjes dhe shqyrtimit të rasteve përjashtimore nga tarifa e shkollimit)

Bazuar në Kushtetuten e Shqipërisë, në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nëni 49/1/e dhe 112, ligjin nr.10296 dt.08.07.2010” Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin të MF nr.30 dt.27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Ligjin nr.9936 date 26.6.2008” Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” si dhe në VKM date 29.03.2017 ”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”

Udhezoi:

Perfitojnë përjashtim nga tarifat e shkollimit për arsyet e mëposhtme vetëm këto kategori: Studentët që janë pranuar në një program:

- Te ciklit të parë të studimeve;
- Te integruar të studimeve;
- Te studimeve profesionale

Studentët të cilët kanë filluar studimet në vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 , të cilët kërkojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit në zbatim të VKM nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, si dhe Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 31, datë 29.12.2017 “Për miratimin e dokumentacionit vërtetues për studentët që aplikojnë për përjashtim ose reduktim të tarifës së shkollimit” duhet të plotësojnë dokumentacionin si më poshtë :

A. Studentë me aftësi të kufizuar të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, student që nuk shikojnë (Verbër)/student tetraplegjik/ paraplegjike.

- a. Fotokopje të noterizuar të vërtetimit të KMCAP (Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë) ose të KMPV (Komisioni i Caktimit të Verbërisë);
- b. Vërtetim original nga njësia e vetëqeverisjes vendore për pagesën e verbërisë/paftësisë që merr studenti;
- c. Vërtetimi nga shoqata e të verbërve të Shqipërisë ose nga shoqata përkatëse;
- d. Fotokopje e noterizuar e Librezës së Verbërisë/Fotokopje e noterizuar e statusit të paraplegjik/ tetraplegjik;
- e. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit.

A/1. Studentët fëmijë të personave/ familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/ përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti e vetëqeverisjes vendore;

- a. Kopje origjinale ose e noterizuar e vërtetimit të KMCAP-së (Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë) për studentin me prindër me aftësi të kufizuar (invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik);
- b. Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës së bashku me fotokopjen me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës të përfitur sipas statusit të invalidit të punës;
- c. Vërtetim original të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit;
- d. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar numrin e dosjes dhe të jetë shënuar qartë shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme). Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vërtetime me korrigjime të pa firmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura;
- e. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës/invalidin paraplegjik/ tetraplegjik;
- f. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit dhe të prindit invalid.

B. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/ përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti bazë të vetëqeverisjes vendore,

- a. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me kryefamiljarin familja e të cilit përfiton ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti e vetëqeverisjes vendore;
- b. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike të ketë të shënuar **numrin e dosjes** dhe të jetë shënuar qartë **shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme)**. Vërtetimi duhet të jetë me

numër protokollit, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vërtetime me korigjime të pa firmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura;

- c. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit.

B/1. Studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Çertifikatë vdekjeje e prindit që u është ndarë nga jeta;
- c. Vërtetime që vërtetojnë të ardhurat vjetore të familjes, si më poshtë:
 1. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që familja përfiton ndihmë ekonomike si familje në nevojë;
 2. Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që asnjë nga familjarët e studentit (personat mbi 18 vjeç) nuk ushtrojnë aktivitet privat;
 3. Vërtetime nëse prindërit apo ndonjë pjestar i familjes mbi 18 vjeç janë të regjistruar si punëkerkues të papunë (nga zyra e punës);
 4. Vërtetim familjarisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (nëse përfitojnë pension ose jo).
 5. Vërtetim nëse familjarët kanë tokë ose pasuri të paluajtshme fitim prurës në pronësi.

B/2. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

- a. Çertifikatë Familjare;
- b. Fotokopje e kartës së identitetit
- c. Çertifikatën e vdekjes së dy prindërve;
- d. Fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit të përfitur nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

B/3. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë

1) Rasti kur studentit e ka humbur përgjegjësinë prindërore nga të dy prindërit;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vendim gjykatë i formës së prerë që studentit ka humbur përgjegjësinë prindërore (nga të dy prindërit) Kopje origjinale ose kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës)

2) Rasti kur studentit e ka humbur përgjegjësinë prindërore nga njeri prind dhe prindi tjetër nuk jeton

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vendim gjykatë i formës së prerë që studentit ka humbur përgjegjësinë prindërore (nga njeri prind) Kopje origjinale ose kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës)
- c. Çertifikatë vdekjeje e prindit tjetër;

C. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qënieve njerëzore;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vërtetim nga Ministria e Mirëqënies Sociale ose Ministria e Brëndshme që kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qënieve njerëzore;

D. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brëndshme dhe ajo e mbrojtjes;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Çertifikatë vdekje e prindit që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- c. Vërtetim konfirmimi nga Ministria përkatëse;

E. Studentët romë dhe Ballkano-egjiptianë, konfirmuar si të tillë nga Ministria e Mirëqënies Sociale

- a. Fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vërtetim antarësie në shoqatën përkatëse;
- c. Vërtetim konfirmimi nga Ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale;

F. Studentët fëmijë të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

- a. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- b. Vërtetim i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
- c. Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brëndshme.

G. Studentët e shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare 10 (dhjetë).

- a. Lista e studentëve për vitin e dytë e lart përpilohet nga sekretaria mësimore dhe protokollohet e firmoset prej tyre, zv. Dekanit dhe Dekanit. Kjo listë i drejtohet komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit të përjashtimit nga tarifa.
- b. Lista e studentëve të vitit të parë hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe në institucionet publike të arsimit të lartë.

II.----- Studentët të cilët kanë filluar studimet në vitin akademik 2014-2015, 2015-2016 dhe 2016-2017 , të cilët kërkojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit në zbatim të VKM nr. 638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartsi dhe tarifat e shkollimit.. “, I ndryshuar me VKM nr.866, datë 23.10.2015 duhet të plotesojnë dokumentacionin si më poshtë :

1.Studentë me aftësi të kufizuar (invalidë) të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftesisë për Punë, studentë që nuk shikojnë (Verbër) / studentë tetraplegjik/ paraplegjike.

- a. Fotokopje të noterizuar të vërtetimit të KMCAV (Komisioni i Caktimit të Aftesisë për Punë) ose të KMPV (Komisioni i Caktimit të Verbërisë);
- b. Vërtetimi nga shoqata e të verbërve të Shqipërisë ose nga shoqata përkatëse;

- c. Fotokopje e noterizuar e Librezës së Verbërisë /Fotokopje e noterizuar e statusit të paraplegjik/ tetraplegjik;
- d. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit të studentit.

2. Studentët femijë të personave/ familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së për punë,

- a. Kopje origjinale ose e noterizuar e vërtetimit të KMCAP-së (Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë) për studentin me prindër me aftësi të kufizuar (invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik);
- b. Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës së bashku me fotokopjen me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës të përfituar sipas statusit të invalidit të punës;
- c. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit;
- d. Vërtetim origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për pagesën e verbërisë/ paaftësisë që merr prindi;
- e. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës /invalidin paraplegjik/ tetraplegjik;
- f. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit dhe të prindit invalid.

3. Studentëve që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Çertifikatë vdekjeje e prindit që u është ndare nga jeta;
- c. Vërtetime që vërtetojnë të ardhurat vjetore të familjes, si më poshtë:
 - 1. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që familja përfiton ndihmë ekonomike si familje në nevojë. Vërtetimi i ndihmës ekonomike të ketë të shënuar **numrin e dosjes** dhe të jetë shënuar qartë **shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme)**. Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vërtetime me korigjime të pa firmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura;

4. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit;

- a. Çertifikatë Familjare;
- b. Fotokopje e kartës së identitetit
- c. Çertifikatën e vdekjes së dy prindërve;
- d. Fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit të përfituar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

5. Studentët femijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brëndshme dhe ajo e mbrojtjes;

- a. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Çertifikatë vdekjeje e prindit që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

- c. Vërtetim konfirmimi nga Ministria përkatëse;

6. Studentët femijë të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose femijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

- a. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose femijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- b. Vërtetim i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
- c. Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brëndshme.

7. Studentët romë dhe Ballkano-egjiptianë, konfirmuar si të tillë nga Ministria e Mirëqënies Sociale

- a. Fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vërtetim antarësie në shoqatën përkatëse;
- c. Vërtetim konfirmimi nga Ministria përgjegjëse për mirëqënien sociale;

8. Studentë të prekur me HIV/AIDS

- a. Fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Vërtetim konfirmimi nga organet shëndetësore.

8. Studentët e shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare 10 (dhjetë),

- a. Lista e studentëve për vitin e dytë e lart përpilohet nga sekretaria mësimore dhe protokollohet e firmoset prej tyre, zv. Dekanit dhe Dekanit. Kjo listë i drejtohet komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit për përjashtimin nga tarifa.
- b. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe në institucionet publike të arsimit të lartë.

III. Të tjera

1. Dokumentacioni duhet të shoqërohet me Formularin e aplikimit dhe vërtetimin e studentit
2. Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë mësimore.
3. Studentët që ndjekin program të dytë studimi nuk përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit.
4. Studentët përsëritës nuk përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit.
5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është 05.12.2018.

DEKANE
Prof. Tatjana ÇINA